



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

KURRIKULA BËRTHAMË

LËNDA: QYTETARI

KLASA: X

Tiranë, 2016



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT:

1. Fusha “Shoqëria dhe mjedisi”

1.1.Hyrje në programin e qytetarisë

2. Korniza konceptuale e programit

2.1.Qëllimet e programit të qytetarisë

2.2.Lidhja e kompetencave të lëndës me kompetencat e tjera kyçe

2.3.Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare

2.4.Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

2.5.Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

3. Koha mësimore për tematikë

4. Rezultatet e pritshme të të mësuarit sipas tematikave

5. Udhëzime metodologjike

6. Udhëzime për vlerësimin

7. Materialet dhe burimet mësimore

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi: të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësi:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Kompleksiteti i botës shoqërore sot përbëhet, për shkak se shoqëritë janë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe lidhjesh globale, shoqëruar me rritje të lartë të

lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje e globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi” zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri demokratike. Ato nxitin zhvillimin intelektual të nxënësit, duke i dhënë mekanizmat konceptualë dhe metodologjikë, të cilët nxënësi mund t’i përdorë në situata të ndryshme, e ndihmojnë të prezantojë botën dhe të përballojë situata të ndryshme në jetën e tij.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve qytetari, sociologji, ekonomi, filozofi, histori, gjeografi, psikologji, etikë etj.. Secila prej tyre e trajton botën dhe shoqërinë nga këndvështrime të ndryshme. Përmes kësaj fushe, nxënësi zhvillon bazat e qytetarisë, duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillon konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Programet e lëndëve qytetari, gjeografi dhe histori janë ngushtësisht të lidhura nga kompetencat që ato synojnë të zhvillojnë te nxënësi. Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni, në këtë shkallë i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyçe, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

1.1 Hyrje në programin e qytetarisë

Qytetaria demokratike bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe shtetit të së drejtës. Ajo lidhet, para së gjithash, me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin qytetar, pjesëmarrjen dhe përkatësinë, respektin për diversitetin. Si e tillë, ajo përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe sektorët e shoqërisë.

Qytetaria demokratike bazohet në një metodë shumëpërmasore, që ka në bazë procesin dhe përfshin:

- ⊕ **Përmasën politike**, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik.
- ⊕ **Përmasën ligjore**, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve.
- ⊕ **Përmasën kulturore**, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore.
- ⊕ **Përmasën shoqërore dhe ekonomike**, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike.
- ⊕ **Përmasën evropiane**, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian.
- ⊕ **Përmasën globale**, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvarësisë dhe solidaritetit global.

Programi lëndor rrjedh nga korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë. Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit**, për zhvillimin e kompetencave të qytetarisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri.
- **Mësuesit**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit**, për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit.
- **Hartuesit të teksteve mësimore** dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Programi i lëndës qytetari për klasën X është hartuar në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat.

- Ky program krijon kushtet për ndërtimin e kompetencave kyçe të nxënimit gjatë gjithë jetës në fushën e qytetarisë demokratike. Kompetencat e synuara në këtë program lidhen me kompetencat e tjera kyçe. Lidhja mes rezultateve të nxënimit të kompetencave të lëndës së qytetarisë dhe, kur është e mundur, të kompetencave të tjera kyçe, siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor. Procesi i nxënimit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, në të gjitha shkallët, ka në fokus të veçantë zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare.
- Kompetencat zhvillohen përmes tematikave të përbashkëta të fushës dhe në program zërthehen në njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime/vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishëm të programit të lëndës së qytetarisë, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Programi i qytetarisë për këtë shkallë të kurrikulës është i strukturuar rreth dy tematikave të mëdha. Për secilën prej tyre përcaktohen rezultatet e pritshme, të shprehur në terma njohurish, shkathtësish dhe qëndrimesh. Rezultatet e nxënimit të kompetencave kyçe nuk përmbushen jashtë tematikave, ato janë marrë në konsideratë në të gjithë procesin e hartimit të rezultateve të nxënimit për tematikë, duke qenë pjesë integrale e tyre.
- Strukturimi dhe organizimi i programit për shkallë kurrikule synon ta bëjë këtë program më fleksibël, duke i ndihmuar dhe lënë dorë më të lirë mësuesve për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese, si dhe të respektojnë ritmet individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës.
- Strukturimi i programit mbi rezultatet e nxënimit për kompetencë ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e situatave të nxënimit dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyçe. Situatat e nxënimit janë situata që lidhen me kontekstin e të

nxënit. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxëni, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësit.

- Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj. Programi i lëndës së qytetarisë krijon mundësi integrimi brenda fushës dhe me fushat e tjera, si shkencat e natyrës, matematikën, gjuhën, artet, etj. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare. Ato shërbejnë si çështje kyçe për zhvillimin e kompetencave, integrojnë fushat e të nxënit dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij, me jetën e përditshme.
- Programi sugjeron metoda, teknika, strategji të mësimdhënies e të nxënies që nxisin interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre.
- Vlerësimi si pjesë integrale e procesit të të nxënit, mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit. Vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

2.1. Qëllimet e programit të lëndës së qytetarisë

Edukimi për qytetari demokratike **synon**:


- ⇒ të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- ⇒ të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- ⇒ të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;
- ⇒ të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike.

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, programi i **lëndës së qytetarisë synon**:

- ⇒ t'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre;

- ⇒ t'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit;
- ⇒ t'u japë nxënësve mundësinë të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



2.2.Lidhja e kompetencave të fushës /lëndës me kompetencat e tjera kyçe

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen me kompetencave kyçe. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të nxënies.

Kompetenca qytetare

Programi i qytetarisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, përmes kërkimit, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare.

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënies të synuara nga programi i lëndës së qytetarisë nxitin, në shkallë të ndryshme, edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i *qytetarisë* krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj, në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si të vlerësojë këto burime dhe të kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënies. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audiencë të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet. Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike

dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bëjnë në terren.

Programi i *qytetarisë* nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik, për interpretimin e të dhënave etj.

Kompetenca e të nxënit

Për të mbështetur edukimin për qytetari demokratike, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

Kompetenca personale

Programi i qytetarisë nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësi kupton rolin e tij në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohet të jetë i pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe në marrjen e vendimeve.

Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.

Diagrami 2: Disa rezultate të të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së qytetarisë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

Nxënësi:

- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;
- veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese*)

Nxënësi:

- parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në medie;
- zgjidh një problem (shoqëror, shkencor...etj) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse;
- përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror);
- shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë;
- krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore;
- përdor krahasimin dhe kondërvënien për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore ndërmjet dy ose më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

Kompetenca e të nxënit (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

Nxënësi:

- përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
- shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlihdh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur;
- menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

Nxënësi:

- zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;
- diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre;

- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.)për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme*)

Nxënësi:

- vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

Kompetenca qytetare (*Nxënësi i përkushtohet të mirës së përbashkët*)

Nxënësi:

- tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit;
- merr pjesë në aktivitetet që nxisin dhe mbështesin tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik,fetar,gjinor etj, në shkollë ose në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)

Nxënësi:

- përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh. hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

2.3. Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e përgjegjësive qytetare, nxënësi mëson të vendosë lidhje ndërmjet nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtarisë njerëzore.

Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

2.4. Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

Lënda e qytetarisë (Njohuri për shoqërinë klasa K II) duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e qytetarisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, lënda e qytetarisë mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Shembuj:

I. Historia dhe qytetaria

Lënda e historisë dhe ajo e qytetarisë kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** për shembull pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria, etj.
- **Aftësitë dhe shprehjet:** për shembull përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj

Qytetaria:

- u jep aktualitet më të madh çështjeve, me të cilat merret historia. Në këtë mënyrë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e historisë për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe qytetarisë?

1. **Së pari**, kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes të çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve etj. të trajtuara në lëndën e historisë në kurrikulën e qytetarisë, me kusht që përmasa e qytetarisë duhet:

- të jetë çështja thelbësore e mësimi;
- të lidhet me kurrikulën e qytetarisë.

2. **Së dyti**, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të qytetarisë. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm:

- **Konceptet:** Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete historike, në të kaluarën dhe në të sotmen.
- **Tema:** Në disa mësimë mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.
- **Fusha kurrikulare:** Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.
- **Përmasa vendore:** historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

3. **Së treti**, historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme

II. Gjeografia (dituria e natyrës) dhe qytetaria

1. Çfarë kanë të përbashkët gjeografia (dituria e natyrës) dhe qytetaria? Ato kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.,
- **Përmbajtjen:** bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj.
- **Temat:** strehimi, komunikimi etj.

2. Si mund të ndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së qytetarisë?

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe te bashkësia ku jetojnë.
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale.
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë.
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qendrueshëm.
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

3. Në ç'mënyrë lënda e qytetarisë ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë?

Qytetaria:

- zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to;
- ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë;
- nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë e ndershme;
- nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

3.1. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Procesi i të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, në të gjitha shkallët, ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare, si një ndër kompetencat kyçe si dhe, në sasinë dhe cilësinë e mundshme, të kompetencave të tjera.

- Kjo kompetencë përbëhet nga kompetencat personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore që përfshijnë dhe lidhen me të gjitha qëndrimet që përgatitin individët për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe konstruktive në jetën dhe punën shoqërore dhe, në mënyrë të veçantë, në shoqëritë gjithnjë e më të larmishme, për të zgjidhur konfliktet atje, atëherë dhe kur kjo është e nevojshme.
- Kompetenca shoqërore dhe qytetare i përgatit individët për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore , ekonomike, politike etj. dhe për t’iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.
- Nxënësi njih dhe pranon rëndësinë që ka zhvillimi i kompetencave të qytetarisë për përgatitjen për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore dhe politike dhe për t’iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.
- Nxënësi argumenton rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për të motivuar pjesëmarrjen e efektshme me të tjerët në jetën publike dhe për t’u solidarizuar në zgjidhjen e problemeve që lidhen me komunitetin lokal dhe më gjerë.
- Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare zhvillohet duke u bazuar në njohuritë për ligjësitë dhe konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut,.
- Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, në njohuritë për ligjësitë dhe ngjarjet bashkëkohore dhe në prirjet për të ardhmen.

- Nxënësi përdor konceptin e kohës dhe të hapësirës në të gjitha gjykimet dhe vendimmarrjet e tij në fushën e historisë, shoqërisë, filozofisë etj.
- Nxënësi zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, kupton vendndodhjen e njerëzve, të rajoneve, të vendeve si dhe të burimeve dhe shpjegon arsyen e kësaj vendndodhjeje.
- Nxënësi eksploron konceptet themelore gjeografike dhe marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore me mjedisin.
- Nxënësi pranon rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe evropian.
- Nxënësi kupton mënyrën si individët mund të sigurojnë shëndetin e tyre më të mirë mendor, intelektual e fizik, në shërbim të vetes, të familjes dhe të mjedisit të tyre shoqëror. Ata njohin lidhjen e mënyrës së shëndetshme të jetesës me zhvillimin e tyre tërësor dhe veprojnë për të realizuar atë.
- Nxënësi njeh konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj. me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën. Ai kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë evropian e më gjerë.
- Nxënësi komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve.
- Nxënësi është i vetëdijshëm që kompetenca bazohet në ndjenjën e integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin. Ai pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor.

- Nxënësit vlerësojnë diversitetin, respektojnë të tjerët dhe përgatiten për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise.
- Nxënësit zhvillojnë vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe Evropian si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitetin kulturor në Evropë.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit, kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave, do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënit të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, mobilizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to. Këto tematika janë:

- Individët, grupet, shoqëria.
- Kultura.
- Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi.
- Pushteti, autoriteti, qeverisja.

3.2. Koha mësimore dhe rezultatet e pritshme të të mësuarit për tematikë

Programi i lëndës së qytetarisë për klasën X zhvillohet në 70 orë mësimore në vit. Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

3. REZULTATET E PRITSHME TË TË MËSUARIT

Tema 1: Ligji Nxënësit kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktura institucionesh sociale si: familja, shkolla, organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët, që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë. Nxënësit marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara në nivele të ndryshme shkollimi, për qëndrime e sjellje të ndryshme, që kanë lidhje me jetën dhe bashkëjetesën paqësore në shoqëri.		
Ligji Orë të sugjeruara: 6 Rezultatet e pritshme të të nxënit		
Njohuritë	Shkathtësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
Ligji, kuptimi, qëllimet, natyra dhe funksionet e tij. Rëndësia e ligjit në shoqëri. Veprimi i ligjit në kohë dhe hapësirë. Ligji dhe vlerat. Rëndësia e marrjes parasysh të vlerave morale, politike, sociale dhe ekonomike në hartimin, kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e ligjeve. Llojet e ligjeve. Larmia e marrëdhënieve shoqërore dhe juridike dhe kuptimi për ligjet si rregullatorë të marrëdhënieve juridike në fushat përkatëse. Zbatimi i ligjit. Rëndësia e zbatimit të ligjit në shoqëri.	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon qëllimin e ligjit; • diskuton për funksionet dhe natyrën e ligjit në shoqëri; • identifikon dhe vlerësojë pasojat e veprimit apo mosveprimit të ligjit në shoqëri; • argumenton me shembuj nga jeta e përditshme domosdoshmërinë e ligjit për shoqërinë; • identifikon dhe diskutojnë për vlerat që qëndrojnë në themel të ligjeve; • shpjegon domosdoshmërinë e llojeve të ndryshme të ligjit në shoqëri; • demonstroi aftësinë të vlerësojnë vlerat në 	Nxënësi: <p>-demonstron qëndrimin e tij ndaj dhunimit apo shkeljes së normave apo ligjeve që kanë pasojat negative për individin dhe grupin shoqëror në të cilin bën pjesë.</p>

<p>Pasojat e zbatimit/moszbatimit të ligjit për individin dhe shoqërinë. Faktorët që ndikojnë në cilësinë e zbatimit të ligjit .</p>	<p>qëndrimin ndaj ligjeve të caktuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> identifikon raste të shkeljeve të ndryshme ligjore dhe të diskutojë për pasojat e tyre për veten, familjen dhe mjedisin ku jeton; evidenton dhe analizon faktorët që ndikojnë në qëndrimin e tij ndaj zbatimit të ligjit. 	
<p>Tema 2: Kushtetuta e Shqipërisë Nxënësi njihet me thelbin e kushtetutës si ligji themeltar i shtetit, si burim i legjislacionit dhe kriter i vlerësimit të tij. Ai njihet me parimet themelore mbi të cilat ngrihet qeverisja demokratike, të cilat janë edhe standardet mbi bazëne të cilave gjykohet dhe vlerësohet realiteti demokratik në Shqipëri.</p>		
<p>Kushtetuta Orë të sugjeruara: 5 Rezultatet e të nxënit</p>		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<p>Kushtetuta - ligji më i lartë i shtetit. Kushtetuta si burim i legjislacionit. Kushtetuta dhe forma e shtetit. Kushtetuta dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kushtetuta dhe struktura e organeve të shtetit dhe kompetencat e tyre. Kushtetuta dhe ndarja dhe balancimi i pushteteve. Disa nga parimet bazë që qendrojnë në themel të Kushtetutës së Shqipërisë. Kuptimi i parimit të barazisë. Raporti ndërmjet lirisë dhe barazisë. Barazia formale dhe barazia reale.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> përshkruan rolin e kushtetutës si ligji themeltar i shtetit; përshkruan parimet kryesore të mishëruara në kushtetutës shqiptare; argumenton rëndësinë e mbështetjes në parimet e kushtetutës për hartimin dhe zbatimin e ligjeve; argumenton domosdoshmërinë dhe rëndësinë e përmirësimit të kushtetutës në përputhje me dinamizmin dhe veçoritë e jetës ekonomike, sociale e politike të shoqërisë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> dëshmon vullnetin të respektojë parimet dhe nenet e kushtetutës që lidhen me jetën në komunitetin në të cilin ai jeton.
<p>Tema 3: Të drejtat e njeriut</p>		

<p>Nxënësit i jepet mundësia të hyjë në botën e të drejtave të njeriut, si një ndër treguesit kryesorë të një shoqërie demokratike. Ata mësojnë të drejtat e njeriut, rëndësinë, kufizimet dhe ndërlidhjen ndërmjet tyre</p>		
<p>Të drejtat e njeriut Orë të sugjeruara: 10 Rezultatet e të nxënit</p>		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<p>Ç'janë të drejtat e njeriut? Kategoritë e ndryshme të të drejtave të njeriut të drejtat civile e politike. të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të drejtat e mjedisit dhe të zhvillimit. Cilat janë të drejtat që duhet të përfshihen në kartën e të drejtave? Pakti Ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale e kulturore dhe Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike. Konventa Evropiane e të drejtave të njeriut. Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut. Të drejtat në konflikt. Kufizimi i të drejtave . Ndërlidhja e të drejtave. Disa nga të drejtat themelore të njeriut të përfshira në Kushtetutën e Shqipërisë. E drejta për të jetuar dhe për ruajtjen e integritetit fizik dhe moral të individit. E drejta e shprehjes. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë. E drejta për t'u informuar. E drejta për t'u martuar dhe patur familje. E drejta për t'u arsimuar. E drejta për punë. E drejta për t'u organizuar.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • jep një përkufizim të të drejtave të njeriut; • dallon lidhjen e të drejtave të njeriut me nevojat bazë të njeriut; • shpjegon lidhjen e të drejtave të njeriut me vlerat dhe interesat e tyre jetësore të sotme dhe të perspektivës; • interpreton konceptimet e ndryshme për të drejtat e njeriut dhe të shprehë qëndrimin e tij vetjak lidhur me to; • përshkruan tiparet kryesore të të drejtave të njeriut dhe të shpjegojë rëndësinë e secilit prej tyre; • përshkruan përmbajtjen e disa prej dokumenteve themelore të të drejtave të njeriut dhe të institucioneve kryesore evropiane të të drejtave të njeriut; • dallon kategoritë kryesore të të drejtave sipas legjislacionit ndërkombëtar; • përshkruan dhe argumenton rëndësinë e kufizimit ligjor të të drejtave të njeriut dhe sferën dhe kushtet e kufizimit të tyre; • përshkruan, me shembuj në jeta e përditshme, lidhjen e të drejtave të njeriut dhe rëndësinë e saj për realizimin e tyre 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dëshmon vigjilencën e tij ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut në shkollë, në komunitet etj. dhe shpreh qëndrimin e tij konkret në lidhje me to; • dëshmon gatishmërinë e tij në përhapjen e kulturës së të drejtave të njeriut dhe të demokracisë në bashkësinë ku jeton.

<p>E drejta për të gëzuar një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët E drejta për një proces të rregullt gjyqësor</p>	<p>tërësor;</p> <ul style="list-style-type: none"> identifikon dhe shpjegon raste të drejtave në konflikt dhe të shprehen për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet të drejtave. 	
<p>Tema 4: Arsimimi Shkolla luan një rol të pazëvendësueshëm për rritjen dhe edukimin e fëmijës nga pikëpamja shoqërore dhe kulturore. Ajo i përgatit fëmijët, jo vetëm për të hyrë me këmbë të sigurt në botën e të rriturve, por edhe që t'i aftësuar të vetëzhvillohen e t'i përshtaten më mirë ndryshimeve të botës.</p>		
<p>Arsimimi Orë të sugjeruara:6 Rezultatet e të nxënës</p>		
<p>Njohuritë</p>	<p>Aftësitë</p>	<p>Qëndrimet</p>
<p>Shkolla, funksioni i saj. Rëndësia e arsimimit. Arsimimi si e drejtë themelore. Konventa për të drejtat e fëmijës. Kushtetuta e Shqipërisë për arsimin. Ligji për arsimin parauniversitar. Si realizohet e drejta për arsimim. Institucionet shkollore, roli dhe përgjegjësia e tyre për të garantuar të drejtën për arsim për të gjithë. Çfarë duhet të studjojmë në shkollë dhe përse? Cilësia dhe barazia në arsim. Si garantohen shanse të barabarta për të gjithë nxënësit? Si garantoher cilësia e shërbimit arsimor për</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> argumenton rëndësinë e arsimimit për jetën e secilit; argumenton të drejtën për arsim si e drejtë themelore; argumenton rëndësinë e mbrojtjes me ligj të drejtës për arsimim; përshkruan disa nga realizimet e ligjit shqiptar për arsimin para-universitar; përshkruan ndryshimet e shkollës në vite; përshkruan mundësitë që ofron arsimimi në vendin tonë; dallon rolin e shkollës dhe të mësuesve; tregon disa nga problemet me të cilat përballet arsimi dhe shkolla jonë sot; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -tregon interes të vazhdueshëm për cilësinë e shërbimit arsimor që ofrohet në shkollë; -shpreh qëndrimin e tij për zgjidhjen e problemeve të shkollës dhe të komunitetit shkollos.

<p>të gjithë?</p> <p>Kush duhet të vendosë për arsimimin tim? Reformat arsimore, arsyet e reformave dhe zbatimi i tyre.</p> <p>Pjesëmarrja e të rinjve në projektimin e reformave arsimore.</p> <p>Shkolla si një shoqëri multi etnike ose multi kulturore.</p> <p>Problemet e shkollës sot.</p> <p>A i shërben shkolla interesave të nxënësve? Çfarë duhet të sigurojë shkolla për të përmbushur këto interesa? Analfabetizmi, analafabetizmi funksional. Standardet e shkollës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përdor njohuritë dhe mjetet e tjera që ofron shkolla për të bërë zgjedhje për vazhdimësinë e arsimimit të tij; • mbledh fakte e të dhëna për problemet e shkollës e të bëjë interpretimin e tyre; • parashikon pasoja të ndryshme të funksionet e shkollës të qëndrimeve, politikave ose ligjeve të ndryshme. 	
<p>Tema 5: Shëndeti</p> <p>Shëndeti është një e drejtë themelore e njeriut. Ruajtja e tij nga rreziqet dhe “armiqtë e shumtë duhet të jetë përparësi jo vetëm e individëve që e kanë por edhe e shtetit. Njohja e tij si e drejtë dhe pranimi i detyrimeve për ruajtjen dhe mirëqënien e tij duhet të jetë detyrim i shtetit dhe i shoqërisë. Në këtë kuadër shkolla duhet të luajë rolin kryesor të informimit në lidhje me shëndetin, rreziqet, përkujdesjet etj.</p>		
<p>Shëndeti Orë të sugjeruara: 6 Rezultatet e pritshme të të nxënit</p>		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<p>Shëndeti si një e drejtë themelore.</p> <p>Shëndeti në dokumentet e të drejtave të njeriut dhe në legjislacionin shqiptar.</p> <p>Mbrojtja e shëndetit në vendin tonë.</p> <p>Parandalimi dhe informacioni.</p> <p>Masat dhe veprimtaritë vetjake në mbrojtje të</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • jep një përkufizim për shëndetin; • vlerëson shëndetin si një të drejtë njerëzore dhe të tregojë mbrojtjen e tij në dokumentet e të drejtave të njeriut; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpreh qëndrimin e tij për çështjet që lidhen me shëndetin; • përfshihet në veprimtari të

<p>shëndetit. Rreziqet e shëndetit dhe siguria. Disa nga mjediset jetësore dhe rreziqet që shoqërojnë veprimtarinë tonë të përditshme.</p> <p>Cilët janë disa nga armiqtë kryesorë të shëndetit ? Legjislacioni shqiptar në mbrojtje të shëndetit kundër armiqve të tillë (sida, alkoholi, droga, duhani, doping etj. Disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin dhe qëndrimet etike për to. Mbështetja me legjislacionin përkatës Detyrimet individuale dhe shoqërore për shëndetin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • argumenton domosdoshmërinë e mbrojtjes me ligj të shëndetit; • tregon si legjislacioni shqiptar e mbron shëndetin; • argumenton rëndësinë e mbrojtjes paraprake të shëndetit dhe e parandalimit të veprimit të faktorëve që e dëmtojnë atë; • argumenton rëndësinë e informimit publik për çështjet e shëndetit; • identifikon dhe të përshkruajë disa nga problemet e sotme në lidhje me shëndetin dhe llojet e tyre; • diskuton për shkaqet kryesore të disa prej problemeve kryesore që lidhen me shëndetin; • dallon disa nga shtresat e pafavorizuara të shoqërisë dhe problemet e tyre që lidhen me shëndetin; • tregon si ligji shqiptar mbron shëndetin e të gjitha shtresave të shoqërisë; • rendit disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin dhe shpreh qëndrimin e tij për to; • përcakton dhe diskuton për detyrimet individuale dhe shoqërore për mbrojtjen e shëndetit. 	<p>shëndetëshme shoqërore, fizike, psikologjike etj.</p>
<p>Tema 6: Mjedisi Mjedisi përbën burimin themelor për jetën në tokë. Megjithatë ai është rrezikuar dhe rrezikohet vazhdimisht nga veprimtaria njerëzore. Brezat e ardhshëm do të trashëgojnë gjithnjë e më pak nga mjedisi i sotëm, pasi i shfrytëzohet pa kriter nga brezat e sotëm. Edukimi i të rinjve me përgjegjësinë e ruajtjes dhe zhvillimit të tij është një përparësi.</p>		
<p>Mjedisi</p>		

Orë të sugjeruara: 6		
Rezultatet e pritshme të të nxënësve		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<p>Ekologjia. Rreziqet për planetin. Mjedisi i shëndetshëm si një e drejtë njerëzore Përpjekjet e njerëzimit për të ruajtur planetin. Roli i shkencës dhe i teknologjisë për ruajtjen e planetit. Si mund të ruajmë planetin? Energjia. Kontradiktat e zhvillimit. Zhvillimi i qëndrueshëm. Politikat evropiane për ruajtjen e mjedisit. Legjislacioni shqiptar për ruajtjen e mjedisit . Ruajtja dhe zhvillimi i mjedisit është përgjegjësi për të gjithë. Si të jetojmë në një mjedis të shëndetshëm dhe për një mjedis të shëndetshëm.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjego lidhjen ndërmjet ruajtjes së mjedisit dhe ruajtjes së vetë njeriut; • vlerëson mjedisin e shëndetshëm si një të drejtë të njeriut ; • tregon si legjislacioni shqiptar mbron mjedisin; • dallon rreziqet me të cilat përballet sot planeti ynë; • identifikon disa nga format e ndotjes së mjedisit në Shqipëri; • rendit disa nga llojet kryesore të ndotjes së mjedisit në bashkësinë ku jetojmë; • bën kërkime të pavarura ose në grup për mënyrën se si trajtohet mjedisi në nivele të ndryshme të qeverisjes vendore ose qendrore; • përkufizon me fjalët e tij termin zhvillim i qëndrueshëm; • shpjegon rëndësinë e marrjes parasysh të pasojave të veprimeve dhe sjelljeve tona mjedisore për brezat e ardhshëm dhe për ardhmërinë në përgjithësi; • tregon me shembuj që mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi individuale; • parashikon disa nga pasojat që kanë për brezat e ardhshëm, zgjedhjet që bëjnë individët, grupet ose shteti. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • diskuton për përgjegjësinë e secilit për mbrojtjen e mjedisit; • ndërmerr veprime konkrete në dobi të mjedisit.

Tema 7: Konsumatori		
Konsumatori Orë të sugjeruara: 8 Rezultatet e pritshme të të nxënësve		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<p>E drejta e konsumatorit dhe përmbajtja e saj.</p> <p>Çdo të thotë të jesh konsumator kur blen, pas blerjes?</p> <p>Faktorët që ndikonë në sjelljen e konsumatorit</p> <p>Zgjedhja e konsumatorit, faktorët që e përcaktojnë atë.</p> <p>Kontrata. Kuptimi i kontratës në ligjin mbi konsumatorin, elementët dhe kushtet e lidhjes së saj. Llojet kryesore të kontratave, pasojat e kontratës, prishja e kontratës dhe pasojat e prishjes së saj.</p> <p>Garancia si pjesë e kontratës, përmbajtja e saj. Si lexohet një garanci.</p> <p>Reklama dhe konsumatori.</p> <p>Procedurat e mbrojtjes pas blerjes.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet kryesore të ligjit mbi konsumatorin; • të përcakton përmbajtjen e konceptit konsumator dhe të përshkruajë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit; • përshkruan disa nga faktorët që ndikojnë në sjelljet e konsumatorit; • demonstron aftësi të shmangë dhe të zgjidhë probleme të thjeshta si konsumator; • analizon dhe përshkruan elementët kryesorë të kontratës së shitblerjes; • shpjegon elementët dhe rëndësinë e garancisë për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të konsumatorit; • përshkruan funksionet e reklamës dhe të analizojë raste të keqpërdorimit të saj si shkelje e të interesave dhe të drjtave të konsumatorit; • identifikon organizata që punojnë e luftojnë për zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e konsumatorit. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • diskuton për rrugë dhe forma të ndryshme të mbrojtjes së konsumatorit; • ndërmarr veprime në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të konsumatorëve të tjerë.

Tema 8: Puna dhe e drejta e punës E drejta e punës sanksionohet në Kushtetutë dhe mbrohet nga legjislacioni i veçanta i cili përmblihet dhe kodifikohet në Kodin e punës. Puna është mjedisi dhe mjeti për realizimin e individit, por që shpesh herë është edhe mjedisi i abuzimit me të. Njohja e legjislacionit të punës është i rëndësishëm për mbrotjen e individve si punëmarrës.		
Puna dhe e drejta e punës Orë të sugjeruara: 6 Rezultatet e pritshme të nxënësit		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<p>Kushtetuta për të drejtën e punës.</p> <p>Kodi i Punës dhe mbrojtja e interesave të punonjësit.</p> <p>Roli i legjislacionit të punës në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve.</p> <p>Të drejtat e punonjësve. Mënyrat e mbrojtjes së tyre.</p> <p>Kontrata e punës.</p> <p>Kuptimi i kontratës së punës. Kushtet e lidhjes së kontratës së punës. Marrëveshja ndërmjet palëve. Shkaku i kontratës, objekti i saj. Forma e kontratës. Llojet e kontratave të punës.</p> <p>Kushtet e punës. Kuptimi i kushteve të punës</p> <p>Mbrojtja në punë. Detyrimet e punëmarrësit për të siguruar mbrojtjen në punë. Mbrojtja e veçantë e të miturve në punë. Koha e punës. Koha e lejes dhe pushimit.</p> <p>Zgjidhja e kontratës dhe humbja e punës.</p> <p>Kuptimi i zgjidhjes së kontratës. Rastet e</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • jep një përcaktim të termave punë dhe punoj; • rendit lloje të ndryshme punësh; • dallon faktorët kryesorë që mundësojnë një proces prodhues; • tregon përgjegjësinë e shtetit për punën; • rendit të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve sipas legjislacionit shqiptar për punën; • rendit disa nga hapat e domosdoshëm për të kërkuar punë; • përshkruan tablonë e disa prej ndryshimeve kryesore që ka pësuar bota e punës në shoqërinë shqiptare dhe pasojat e tyre për botën e punës në Shqipëri; • përshkruan disa nga tiparet kryesore të botës së punës në Evropë dhe kërkesat që shtron ajo për të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të jetojnë në të; • diskuton për disa nga dukuritë, me të cilat ndeshen emigrantët shqiptarë në botën e 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mban qëndrim aktiv në njohjen e të drejtave të punës dhe të detyrimeve të punëdhënësit dhe e shpreh qëndrimin e tij në rastet kur identifikon shkelje të të drejtave vetjake dhe të të tjerëve në këtë drejtim.

<p>zgjidhjes së kontratës. Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme.</p> <p>Zgjidhja e kontratës për shkaqe të arsyeshme. Afati i zgjidhjes së kontratës.</p> <p>Sigurimi shoqëror. Kuptimi mbi sigurimin shoqëror. Sigurimi shoqëror në legjislacionin shqiptar. Sigurimi shoqëror dhe interesat aktuale dhe perspektive të punonjësve Sigurimi shoqëror dhe realiteti shqiptar.</p>	<p>punës jashtë Shqipërisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • mbledh fakte e të dhëna për problemet e punës së fëmijëve e të bëjë interpretimin e tyre; • parashikon pasoja në aspekte të ndryshme të jetës së fëmijës qëndrime ose praktika të caktuara që lidhen me punën e fëmijëve në familje ose në shoqëri; • përshkruan disa nga të drejtat e tij në punë dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre; • diskuton për rëndësinë e legjislacionit të punës për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të punonjësve; • jep përkufizimin e kontratës sipas legjislacionit dhe të përshkruajë elementët e saj; • rendit disa nga hapat e domosdoshëm për mbrojtjen e interesave të tij në punë. 	
<p>Tema 9: Siguria në rrugë</p>		
<p style="text-align: center;">Siguria në rrugë Orë të sugjeruara: 8 Rezultatet e pritshme të nxënësve</p>		
<p style="text-align: center;">Njohuri</p>	<p style="text-align: center;">Aftësi</p>	<p style="text-align: center;">Qëndrime</p>
<p>Kodi rrugor. Sinjalet rrugore dhe kuptimi i tyre. Llojet e sinjaleve rrugore. Këmbësorët . Qarkullimi i këmbësorëve. Kalimi i rrugës. Kalimi i këmbësorëve në kryqëzime.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan qëllimin e kodit rrugor dhe funksionet kryesore të tij; • përcakton sinjalet kryesore rrugore që rregullojnë qarkullimin e këmbësorëve, biçikletave dhe motoçikletave; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton rregullat e qarkullimit në të gjitha rastet.

<p>Përdorimi i mjeteve publike.</p> <p>Qarkullimi i çiklistëve.</p> <p>Qarkullimi i biçikletave. Qendrimi në karrexhatë.</p> <p>Kthesat dhe ndryshimi i drejtimit.</p> <p>Kryqëzimet dhe rregullat e përparësisë.</p> <p>Shpejtësia dhe distanca e sigurisë.</p> <p>Parakalimet.</p> <p>Qarkullimi i motoçikletave .</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përcakton sjelljen e këmbësorëve, biçikletave dhe motoçikletave në rrugë në raport me përdoruesit e tjerë të rrugës; • merr vendim për lëvizjen e tij në rrugë në përputhje me rregullat e qarkullimit rrugor; • gjykon për rregullsinë ose parregullsinë e lëvizjes së përdoruesve të rrugës; • vlerëson dhe të parashikojë pasojat e moszbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor për individët dhe shoqërinë etj. 	
<p>Tema 10: E drejta për informim dhe ligji për medien</p> <p>Informacioni është thelbësor për çdo shoqëri demokratike. Ai është e drejtë dhe detyrim. Ai është pushtet dhe për këtë arsye, shpesh herë përdoret në mënyrë të padrejtë, në dëm të interesave të individëve, grupeve ose shoqërisë. Si i tillë ai duhet të jetë vazhdimisht në qendër të shikimit kritik.</p>		
<p align="center">E drejta për informim dhe ligji për medien Orë të sugjeruara: 6 Rezultatet e pritshme të nxënësve</p>		
<p align="center">Njohuri</p>	<p align="center">Aftësi</p>	<p align="center">Qëndrime</p>
<p>Informimi dhe rëndësia e tij</p> <p>Informimi dhe mjetet e tij.</p> <p>Mjetet tradicionale të informimit.</p> <p>Mjetet e reja të informimit.</p> <p>Të përditshmet.</p> <p>Gjuha e informimit dhe e pamjeve .</p> <p>Media dhe mitet e saj (mitet e TV)</p> <p>TV dhe ligji për të miturit.</p> <p>Interneti, avantazhet dhe disavantazhet.</p> <p>Rreziqet.</p> <p>Informacioni në dokumentet kryesore të të</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • jep një përshkrim të konceptit informacion; • përshkruan mjetet kryesore tradicionale dhe të reja të informacionit; • flet për mundësitë dhe kufizimet e informacionit; • shpjegon rëndësinë e vlerësimit kritik të informacionit; • shpreh qëndrimin e tij për lirinë e medias 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpreh qëndrimin e tij në mbrojtje të të drejtës së informimit; • mban dhe shpreh qëndrimin e tij kundër rasteve të abuzimit me të drejtën e informimit.

<p>drejtave të njeriut. E drejta e informimit në Kushtetutën e Shqipërisë . Legjislacioni shqiptar për medien e shkruar dhe atë elektronike. E drejta e informimit dhe abuzimet me të. Disa nga problemet bashkëkohore në lidhje me informimin.</p>	<p>dhe për ligjin shqiptar që lidhet me të drejtën e informacionit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • mbledh fakte e të dhëna për problemet e informimit të rinjve e të bëjë interpretimin e tyre; • parashikon pasoja të ndryshme të qëndrimeve të medias në jetën e fëmijës. 	
<p>Tema 11: Bashkëjetesa në komunitetet Bashkëjetesa në bashkëpronësi kërkon detyrime nga të gjithë anëtarët e saj. Shpesh herë këto detyrime nuk respektohen dhe kjo krijon probleme të mëdha për jetesën e përbashkët. Njohja me ligjin dhe detyrimet dhe të drejtat e jetesës në bashkëpronësi do të ndihmojë në zgjidhjen afatgjatë të këtyre problemeve dhe do të përmirësojë jetën e anëtarëve të saj</p>		
<p style="text-align: center;">Bashkëjetesa në komunitet (bashkëpronësi) Orë të sugjeruara: 3 Rezultatet e pritshme të të nxënimit</p>		
<p>Njohuri</p>	<p>Aftësi</p>	<p>Qëndrime</p>
<p>Bashkëpronësia dhe bashkëpronarët. Asambleja e bashkëpronarëve - detyrat e saj. Rregullorja e asamblesë, marrja e vendimeve në bashkëpronësi. Komuniteti (pallati, lagja, bllok pallatesh) dhe detyrat e tij. Komuniteti dhe problemet e tij sot. Detyrimet e përbashkëta. Vështirësitë e përmbushjes së detyrimeve të përbashkëta.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përkufizon konceptet “bashkëjetesës në bashkëpronësi” dhe “bashkëpronarë”; • përshkruan detyrimet e përbashkëta të anëtarëve të komunitetit; • dallon disa prej problemeve kryesore që ndeshen sot në bashkëjetesën në komunitet; • eksploron problemet që ndeshen në komunitetin e tij dhe të analizojë shkaqet kryesore të problemeve që lidhen me bashkëjetesën në këtë komunitet; • përshkruan ligjin për bashkëjetesën në komunitet, funksionet, nenet, pasojat e zbatimit dhe të moszbatimit të tij. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • me vullnetin e tij përmbush detyrimet ndaj komunitetit dhe • nxit pjesëmarrjen e të tjerëve në mbarëvëajtjen e jetesës në bashkëpronësi.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përmbajtja e lëndës së qytetarisë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në :

- ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe nxënësve;
- shfrytëzimin e përvojave personale të nxënësve;
- pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore;
- pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake;
- përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis mësimeve dhe të nxënësve, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimit nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi i kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar dhe si e tillë ajo nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënësve, kur roli i mësuesit është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai motivon një ndërveprim të efektshëm midis nxënësve dhe mësuesit, midis punës në grupe të vogla dhe të mëdha, midis punës së pavarur dhe asaj individuale, por përparësi duhet të marrë stimulimi i ideve të ndryshme, të shumta të dalë nga nxënësit, reflektimi kritik i tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Një element i një rëndësie të veçantë konsiderohen produktet e veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Produktiviteti i nxënësve shihet si një tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Pretendimet e kësaj lënde janë të mëdha. Përmbajtja e saj del jashtë kufijve të orës mësimore, të strukturave tradicionale të shkollës. Ajo thyen “disiplinën” mësimore në klasat tona. Ajo kërkon debat, gjallëri, mbajtje qëndrimesh, opinione të ndryshme, këndvështrime të shumëllojshme nga ana e fëmijëve, gjë që nuk është e lehtë, pasi kjo lidhet me formimin gjuhësor, shkencor dhe aftësitë personale të fëmijëve, të cilën ua mundësojnë edhe lëndë të tjera të kurrikulës së këtij cikli shkollimi. Në këtë kontekst lënda e qytetarisë ndërthur dhe integron natyrshëm shumë njohuri të fituara në lëndë të tjera.

Një aspekt tjetër i shtjellimit të kësaj lënde është përdorimi i përvojave personale, i ngjarjeve të ndryshme të komunitetit ku ata bëjnë pjesë, si raste studimi për shumë tema mësimore dhe objektiva që synon të pëmbushë kjo lëndë.

Në këtë kuptim “rastet e studimit” nga komuniteti shërbejnë si ura lidhëse midis formimit të nxënësve në shkollë dhe jetën reale që përballojnë, por efektiviteti i kësaj mënyre të vepruarit reflektohet natyrshëm në qëndrimet që nxënësi do të mbajë konkretisht brenda grupit shoqëror, të cilit i përket.

Mësuesit përdorin dhe zhvillojnë në mësimdhëniet e tyre modele të ndryshme të saj, por ky program kërkon së pari planifikimin dhe zhvillimin e mësimdhënies ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues-nxënës, mjedis fizik, materiale didaktike, personale të mësuesit dhe nxënësit, si dhe produkte të shumta të hartuara dhe përgatitura nga vetë nxënësit, ku puna në grupe është e rëndësishme, por e shoqëruar patjetër me punën e pavarur dhe atë individuale.

Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së qytetarisë?

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- *dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta* në: lëndët mësimore; teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor; përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative; (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit); parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënës; organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;
- *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj*, në të gjitha përmasat e tij:
 - a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm;
 - b) në administrimin elastik të orëve të mësimi dhe të grupeve;
 - c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim;
 - d) në vlerësimin e ndërsjellë;
- *synimet edukative të shumfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat* marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t’i mësojë ose t’i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimi të nxënësve për t’u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t’i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tjerat;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;

- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuara nga kurrikula e fshehtë.

Mjedisi i të nxënit të qytetarisë demokratike

Edukimi për qytetari demokratike nxit dhe nxitet nga një mjedis të nxëni demokratik në shkollë dhe nga një metodë që synon të përfshijë të gjithë shkollën, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve në marrjen e vendimit dhe sa më shumë të jetë e mundur në kurrikulën e arsimit formal dhe joformal.

Ai kërkon që nxënësit të njihen dhe të pranohen si subjekte të drejtash, nga njëra anë, dhe si bartës të drejtash, nga ana tjetër.

Edukimi për qytetari demokratike zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe të komunitetit, duke nënkuptuar edhe bashkëveprimin ndërmjet të nxënit formal dhe joformal. Si i tillë ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare për zhvillime autonome në të gjitha nivelet.

Edukimi për qytetari demokratike duhet të zhvillohet duke vendosur partneritete ndërmjet aktorëve në edukimin për qytetari demokratike, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës demokratike të rinisë dhe në vetëshprehjen dhe aspiratat e nxënësve dhe e të rinjve për t'u dëgjuar; duke e shndërruar këtë në bazë të edukimit për qytetari demokratike; duke ndërmarrë kërkime që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e edukimit për qytetari demokratike, për trajnimin dhe zhvillimin e kurrikulave; duke nxitur informacionin për përdorimin e teknologjive të komunikimit në fushën e arsimit; duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës, kriterëve të informacionit dhe mbështetjes së nismave e të së drejtës për të shfrytëzuar ICT në fushën e edukimit për qytetari demokratike; duke zhvilluar vetëdijen dhe praktikën e mishërimit të përgjegjësishë shoqërore.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Programi i lëndës së qytetarisë duhet t'u krijojë mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënët e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motive, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. dhe të zhvillojnë mësimin në mënyrë të tillë që përputhet me stilet e të nxënët të nxënësve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta.

a) Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënët njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të rezultateve të pritshme të të nxënët, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve, që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënët e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

b) Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënët brenda dhe jashtë shkollës.

4. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Kompetencat e lëndës së qytetarisë përfshijnë tre elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale e të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve, të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet të tilla, si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
 - Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
 - Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuar gjerësisht nga shoqëria jonë?
 - Cili është roli i qytetarit në demokraci? etj.
- a. Aftësitë intelektuale e pjesëmarrëse të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e për të zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.**
- **Aftësitë intelektuale** i aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, të marrin dhe të mbrojnë qëndrime të caktuara për çështje të jetës publike.
 - **Aftësitë pjesëmarrëse** i përgatisin qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe qytetare, duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe duke shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, duke kërkuar mirëkuptim, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një pjesë të rëndësishme në lëndën e edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimi, në atë shkallë që është e mundshme, të aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse. Këtu duhet të sqarojmë se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë **prirjet qytetare** që përshkruajnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë;
- për të respektuar vlerat vetjake dhe dinjitetin njerëzor;
- për të marrë përsipër përgjegjësitë vetjake, politike dhe ekonomike të qytetarit;
- për t'iu bindur “rregullave të lojës”, si: pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të pakicave;
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirëinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve duhet të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar.**

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare, të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohej të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinioneve të të tjerëve. Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse më parimet kushtetuese.

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë.

5. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.

Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënësve. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, objekte të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizive, etj. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet web për njohuri për shoqërinë.
- Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit për temat që studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm software.
- Përdorimi i simulimeve software.
- Përdorimi i grafikëve software.
- Paraqitja grafike e të dhënave.